

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kolegji Universitar Pavarësia Vlorë

KODI I ETIKËS

NË KOLEGJIN UNIVERSTITAR **"PAVARËSIA VLORË"**

(Miratuar me Vendim nr. 33, datë 14 .11.2017, të Senatit Akademik)

Vlorë, 2017

KODI I SJELLJES DHE ETIKËS

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kolegji Universitar Pavarësia Vlorë udhëhiqet nga standardet më të larta të etikës, në të gjithë veprimtarinë e tij. Çdo anëtar i komunitetit të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë-staf (përfshirë anëtarë nderi, të përhershëm, të ftuar), studentë, anëtarë bordi, komisionesh dhe të gjithë strukturave të tjera të kolegjit ka përgjegjësi që të veprojë në mënyrë etike, në përputhje me parimet e përgjithshme ligjore dhe morale, që udhëheqin veprimtarinë e këtij institucioni. KUPV njih rëndësinë e vlerave etike dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me to, që nga themelimi. Qasja etike e KUPV pasqyrohet në të gjitha aktet e brendshme të këtij institucioni, nëpërmjet dispozitave të veçanta. Aktet e brendshme që rregullojnë veprimtarinë e KUPV kanë vendosur themelet e zbatimit të politikave në respekt të rregullave të etikës në institucion dhe shtrihen në mësimdhënie, kërkimin shkencor, përcjelljen e dijeve, kryerjen e investimeve, financimeve, prokurimeve. Ky kod etike jep një qasje të përgjithshme dhe të unifikuar të etikës në KUPV, duke detajuar dhe përgjithësuar parimet dhe rregullat etike, që qendrojnë në themel të vlerave të tij.

Neni 1

Baza Ligjore

Ky Kod hartohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Statutin e KUPV, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij Kodi.

Neni 2

Qëllimi dhe fusha e veprimit

Kodi i Sjelljes dhe Etikës në KUPV është një përmbledhje tërësore e vlerave dhe parimeve të cilat duhet të udhëheqin punën e përditshme të të gjithë komunitetit të KUPV, duke përfshirë studentët, stafin akademik, administrativ, përfshirë edhe atë vendimarrës apo manaxherial. Kodi ka si qëllim të shërbejë si udhëzues lidhur me veprimet e përditshme të mësimdhënies dhe administrimit, përfshirë edhe ato vendimmarrëse, në përputhje me misionin, parimet dhe vlerat tona.

Ky Kod duhet të konceptohet si plotësues i nevojshëm i kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015.

Ky Kod përcakton parimet e përgjithshme të etikës dhe sjelljes së mirë administrative, shkencore, përcjellëse të dijes, të cilat zbatohen në marrëdhëniet ndërmjet të gjitha niveleve të stafit akademik dhe administrativ të KUPV, studentëve, në marrëdhënie me të tretët, me të cilët KUPV hyn në marrëdhnie kontraktuale, ligjore dhe të tjera.

Qëllimi i këtij Kodi është promovimi i rregullave të sjelljes dhe etikës profesionale për punonjësit e KUPV, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet e tjera të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod do të zbatohen ng i gjithë personeli akademik dhe administrativ, përfshirë edhe anëtarët e organeve drejtuese, autoritet drejtuese, si edhe nga studentët. Efektet e tij shtrihen në të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të KUPV.

Neni 3 **Parimet e Përgjithshme**

3.1. PARIMI I LIGJSHMËRISË - Çdo anëtar i KUPV duhet të veprojë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet dhe aktet nënligjore, kontratat individuale të punës Statutin dhe Rregulloren e brendshme, brenda të drejtave e dhe detyrave të tyre.

3.2. PARIMI I MOSDISKRIMINIMIT - Ndalohet çdo lloj diskriminimi mbi bazë race, ngjyre, seksi, orientimi fetar, origjine kombëtare, origjine shoqërore, lidhje familjare, gjendje civile, formimi kulturor, moshe, paaftësie fizike, bindje politike etj.

3.3. PARIMI I INTEGRITETIT – Stafit akademik në kryerjen e detyrave duhet të jenë të ndershëm, të paanshëm dhe efikasë, duke konsideruar interesin e anëtarëve të tjerë të institucionit dhe atë publik mbi atë privat. Të gjithë anëtarët e KUPV duhet të veprojnë me ndershmëri dhe në të mirë të interesit të përgjithshëm. Çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ nuk duhet në asnjë mënyrë të kërkojë ose të marrë drejtëpërdrejtë ose tërthorazi dhurata, shërbime apo përfitime të çdo lloj natyre nga persona të tretë në këmbim të një trajtimi të privilegjuar ose favorizimi.

3.4. PARIMI I PROFESIONALIZMIT DHE ETIKËS NË PUNË – Anëtarët e KUPV duhet të jenë të sjellshëm si dhe të respektojnë kolegët, eprorët dhe drejtuesit e ILA, studentët, si dhe të drejtat dhe interesat personale të të tretëve. Ata duhet të shmangin sjellje të cilat mund të shihen si ngacmim, kërcënim apo frikësim.

3.5. PARIMI I SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE – Çdo anëtar i KUPV nuk duhet të lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozicionin, të shmangin konfliktin e interesave dhe të mos shfrytëzojnë asnjëherë pozitën për interesa private.

3.6. PARIMI I KONFIDENCIALITETIT – Anëtarët e KUPV duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që kanë në zotërim, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligj Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Informacionin e marrë gjatë përmbushjes së detyrave të tij duhet ta përdorë vetëm për qëllimin për të cilin është marrë dhe duhet ta menxhojë dhe organizojë në një mënyrë të atillë që të shmangë dhe parandalojë çdo lloj nxjerrje, qoftë edhe të pavullnetshme të tij.

3.7. PARIMI I BASHKËPUNIMIT – Çdo anëtar i KUPV dhe çdo punonjës/akademik në të gjitha strukturat pjesë e organigramës së KUPV duhet të sigurojnë bashkëpunimin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave funksionale dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, me qëllim realizimin e misionit të IAL për ofrimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Neni 4 **Vlerat bazë**

- 4.1. Përgjegjshmëri për arritjen e rezultateve cilësore në kuadër të realizimit të qëllimit të IAL.
- 4.2. Përkushtim dhe pasion në mësimdhënie, kërkim shkencor, efektivitet dhe ndershmëri financiare.
- 4.3. Ndershmëri, integritet, besueshmëri, profesionalizëm.
- 4.4. Transparencë dhe respektimi i mendimit ndryshe.
- 4.5. Punë e përbashkët në grup, e bazuar në sinqeritet dhe në besim reciprok.
- 4.6. Dhënie mundësie zhvillimi të gjithëve dhe respektimi i mendimeve dhe sugjerimeve të ndryshme.
- 4.7. Inkurajimi i marrjes përsipër dhe i përballimit të sfidave dhe përgjegjësi.

KREU II **DETYRIME TË PERSONELIT TË KUPV**

Neni 5 **Prona e IAL**

- 5.1. Personeli dhe drejtuesit e çdo niveli kanë detyrimin ligjor të mbrojnë dhe ruajnë pronën e KUPV.
- 5.2. Mjetet e punës, pajisjet dhe aparaturat, si edhe mjediset të cilat i janë vënë në dispozicion, duhet të përdoren vetëm për kryerjen sa më mirë të detyrës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, statutin dhe rregulloren e brendshme. Përdorimi i tyre për qëllime personale është i ndaluar dhe kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore dhe ndëshkohet me masa disiplinore siç parashikohen në Kontratën Individuale të Punës.

Neni 6 **Koha e punës**

- 6.1. Personeli akademik dhe administrativ, duke përfshirë edhe autoritet drejtuese duhet të përdorin në mënyrë efektive kohën e punës për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi, të cilat u janë ngarkuar në përputhje me përshkrimin e punës.

6.2. Koha e punës nuk duhet përdorur për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera të ligjshme është i autorizuar nga eprori përkatës.

6.3. Punonjësi duhet të respektojë dhe zbatojë me efektivitet orarin e punës. Rastet e mosparaqitjes në detyrë duhet të shoqërohen me justifikim të arsyeshëm.

Neni 7

Rregullat e veshjes dhe të tjera gjatë orarit të punës

7.1. I gjithë personeli i KUPV, gjatë orarit të punës si dhe në takime, leksione dhe seminare, trajnime, konferenca, simpoziume etj. duhet të kenë veshje të rregullt, e cila shpreh nivelin e duhur të higjenes, kujdesit dhe serioziteti e pranueshëm.

7.2. Personeli i KUPV duhet të kenë një sjellje të mirë dhe të denjë me qëllim respektimin e moralit dhe ligjit gjatë ushtrimit të funksionit.

7.3. Çdo anëtar i personeli të KUPV duhet të kujdeset për të siguruar një mjedis bashkëpunimi, jo diskriminues, të paanshëm dhe në respekt të parimit të meritokracisë si në raport me kolegët, vartësit edhe studentët.

7.4. Çdo anëtar i personeli të KUPV duhet të përdorë një komunikim korrekt, etik, me një fjalor të zgjedhur dhe një sjellje qytetare.

7.5. Personeli i KUPV duhet të veprojë në përputhje me politikat dhe procedurat e KUPV, në përmbushje të misionit dhe realizimit të vlerave të tij.

7.6. Personeli i KUPV gëzon të drejtën për të kryer aktivitetin e tij në ambiente të shëndetshme dhe të sigurta. Ai duhet t'i zbatojë me përpikëri rregullat që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe duhet t'i raportojë menjëherë eprorit të drejtpërdrejtë për çdo problem shëndeti dhe sigurie.

7.7. Personeli i KUPV nuk duhet të bëjë dallime mes studentëve, kolegëve ose vartëse për shkak preferencash ose njohjesh personale, nuk duhet të disfavorizojë ato në mënyrë të padrejtë. Vlerësimi duhet bërë në mënyrë objektive, në bazë të meritës.

7.8. Personeli i KUPV duhet të ruajë integritetin, vlerat profesionale të akademikëve dhe profesionistëve, të promovojë interesat më të ira të KUPV.

Neni 8

Pijet alkoolike dhe përdorimi i substancave të paligjshme

8.1. Ndalohet rreptësisht mbajtja dhe përdorimi i pijeve alkoolike për të gjithë personelin në mjediset e punës apo jashtë mjediseve të punës gjatë orarit zyrtar.

8.2. Askush nuk duhet të paraqitet në mjediset e KUPV nën efektin e pijeve alkoolike apo substancave të paligjshme në gjendje të tillë, duke penguar përmbushjen efektive të detyrave të tij profesionale.

Neni 9

Ndalimi i Duhanit

9.1. Ndalohet rreptësisht pirja e duhanit në mjediset e KUPV, auditore, në zyra, shkallë, korridore apo ambiente të tjera.

9.2. KUPV përcakton vendet se ku lejohet pirja e duhanit, të cilat i bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të KUPV përmes tabelave përkatëse.

Neni 10

Puna në grup

10.1. Personeli i KUPV, duke përfshirë atë akademik dhe administrativ duhet të jenë të aftë të punojnë në grup dhe t'i përshtaten kërkesave të punës në grup.

10.2. Ata duhet të koordinojnë përmbushjen e detyrave të tyre profesionale me ato të pjesës tjetër të grupit, si dhe të mos bëhen pengesë për përmbushjen e këtyre detyrave, me qëllim arritjen e misionit të KUPV për të mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, në kuadër të plotësimit të interesave të gjithë komunitetit të ILA-së.

Neni 11

Norma të sjelljes në KUPV

11.1. KUPV garanton një ambient pune dhe studimi e kërkimi shkencor të mbrojtur nga ngacmimet ose çdo shqetësim tjetër.

11.2. Ngacmime të personelit nga njëri-tjetri, eprori i tyre, ose të stafit akademik e administrativ ndaj studentëve dhe e kundërta janë të ndaluara.

11.3. Janë rreptësisht të ndaluara ngacmimet dhe/ose mesazhet ngacmuese, provokuese, diskriminuese, përgojuese, shpifëse, mashtruese ose kërcënuese, duke përfshirë ato që flasin në mënyrë ofenduese për racën, seksin, moshën, orientimin seksual, fenë, bindjet politike, origjinën kombëtare, invaliditetin, prejardhjen etnike, statusin e veteranit, identitetin e gjinisë ose çdo karakteristikë tjetër të mbrojtur nga ligji përkatës.

11.4. Nuk lejohet shpërndarja e paautorizuar e informacionit të rezervuar apo konfidencial.

11.5. Nuk lejohet shkaktimi ose lejimi i thyerjeve të rregullave të sigurisë ose ndërhyrjeve të komunikimit në rrjet dhe/ose dhënia në mënyrë të papërshtatshme e fjalëkalimit personal, personave të tjerë ose lejimi i personave të tjerë, që të përdorin fjalëkalimin personal.

11.6. Nuk lejohet shkelja e të drejtave të ndonjë personi apo subjekti të mbrojtur nga e drejta e autorit, sekretit tregtar, patentës ose ndonjë të drejte tjetër të pronësisë intelektuale, të mbrojtur me ligj.

11.7. Nuk lejohet shkelja e të dhënave personale të mbrojtura me ligj.

11.8. Përveç rasteve kur kufizohet me ligj, KUPV ruan të drejtën që të monitorojë pajisjet dhe aktivitetet e rrjetit, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në e-mail, përdorimin e internetit dhe ndonjë informacion të ruajtur. Gjithashtu mund të monitorohen e kamera ambiente të caktuar për efekt sigurie.

11.9. Shkelja e përcaktimeve të këtij neni përbën shkak për fillimin procedurave disiplinore ndaj shkelësit të detyrimeve të përcaktuara më lart.

Neni 12

Mundësi të barabarta punësimi

12.1. KUPV është e angazhuar për të ofruar mundësi të barabarta punësimi, rritje në karrierë dhe shpërblim për punën e kryer mbi bazë kualifikimesh dhe jo në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, kombësisë, shtetësisë, fesë, orientimit seksual, statusit civil, personave me aftësi ndryshe etj. Formimi akademik dhe vlerat profesionale janë kriteret e përzgjedhjes për stafin akademik dhe administrativ të KUPV. Performanca, bazuar në parimin e meritokracisë janë kriteret që udhëheqin rritjen profesionale dhe zhvillimin e karrierës së secilit.

Neni 13

Zgjidhja e problemeve dhe konflikteve

13.1. Personeli i KUPV duhet të komunikojnë me kolegët e tyre dhe persona të tjerë me të cilët ata bashkëpunojnë me mirësjellje dhe dinjitet.

13.2. Komunikimi me mirësjellje është detyrim të zbatohet nga i gjithë stafi pavarësisht nga detyra që ato mbajnë në IAL.

13.3. Autoritet Drejtuese të KUPV, por edhe të njëjstëve të kryesorë dhe atyre bazë, përfshirë edhe Autoritetet Drejtuese Administrative kanë përgjegjësinë që të jenë të disponueshëm për punonjësit e varësisë, të cilët duan të ngrenë çështje apo shqetësime në konfidencë, duke trajtuar me paanshmëri dhe ndjeshmëri situatat që mund të krijohen.

13.4. Ata duhet t'i nxisin punonjësit në varësi që të shprehin idetë e tyre dhe të përfshihen në vendimmarrje në çdo rast kur është e nevojshme.

Neni 14

Përdorimi dhe përhapja e informacionit të klasifikuar

14.1. Çdo person, që si pjesë e personelit të KUPV ka akses në të dhëna të konsideruara si informacion i klasifikuar ka përgjegjësinë të mbrojë sigurinë e informacionit të klasifikuar, të njohur apo të prodhuar gjatë punës, si dhe duhet të jetë i kujdesshëm për mënyrën e përdorimit të këtij informacioni duke shmangur përhapjen e paautorizuar të tij.

14.2. Gjatë marrëdhënies së punës në KUPV dhe pas përfundimit të saj, është i ndaluar zbulimi apo publikimi i informacioneve jopublike, të cilat janë përfutur si rezultat i kryerjes së detyrave funksionale apo përdorimit të këtij informacioni për përfitime personale.

KREU III

TË DREJTA DHE DETYRIME TË STUDENTËVE TË KUPV

Neni 15

15.1. Studentët duhet të respektojnë parashikimet e këtij kodi, duke përfshirë respektimin e normave etike, morale e të qytetarisë së mirë gjatë gjithë periudhës që ata mbajnë statusin e studentit të KUPV.

15.2. Studentët duhet të respektojnë orarin e mësimit dhe tërësinë e rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e KUPV.

15.3. Paraqitja e jashtme e studentëve në KUPV duhet të jetë serioze dhe e përshtatshme për mjediset e një institucioni të arsimit të lartë.

15.4. Studentët duhet të respektojnë dhe sillen në mënyrë etike me njëri – tjetrin dhe me personelin akademik, ndihmës mësimesh-shkencor dhe personelin

Administrativ.

15.5. Studentët nuk duhet të kryejnë veprime dhe gjeste provokuese/ ngacmuese/ diskriminuese ndaj njëri tjetrit dhe personelit akademik në mjediset e KUPV.

15.6. Është rreptësisht e ndaluar që studentët të ofrojnë dhurata apo forma të tjera shpërblimi për të kërkuar favore të padrejta nga personeli akademik.

15.7. Studentët duhet të jenë transparentë dhe korrektë gjatë procesit mësimesh, duke mos iu shmangur shlyerjes së detyrimeve akademike dhe duke mos i shlyer ato me mashtrim ose kopjim, si forma të palejuara dhe të dënueshme për procesin mësimesh/ shlyerjen e detyrimeve akademike.

15.8. Të mos konsumojnë pije alkoolike, duhan, apo substanca të tjera të ndaluara në mjediset e institucionit.

15.9. Të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit. Të mos kenë/mbajnë celular gjatë provimit në auditor.

15.10. Të mbajnë me vete përgjatë procesit mësimesh kartën e studentit dhënë nga KUPV, dhe ta paraqesin/dorëzojnë atë sipas një kërkesë të bazuar nga anëtarët e personelit akademik apo administrativ të institucionit.

15.11. Studenti i cili përfshihet në një veprim të ndaluar apo thyerje ligji, i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit mund të detyrohet nga pedagogu të lërë auditorin për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për përjashtime më të gjata si pasojë e prishjes së orës së mësimit duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse.

Neni 16

Si anëtarë të KUPV, studentët gëzojnë të drejtat dhe liritë si vijon:

16.1. Çdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi racor, fetar, etnik, për shkak të përkatësisë politike, moshës, gjinisë dhe aftësive të kufizuara.

16.2. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikën e institucionit, nuk ndërhyjnë në drejtimin efektiv të kurseve universitare dhe respekton të drejtat e të tjerëve.

16.3. Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda institucionit. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në përputhje me Statutin e KUPV. Organizatat e njohura dhe të pranuar mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e institucionit sipas politikave dhe procedurave administrative të KUPV.

Neni 17

Sjelljet e ndaluara

Sjelljet e ndaluara të cilat përbëjnë shkelje të rënda të Kodit të Etikës, përfshijnë:

17.1. Veprimet e çfarëdo lloji, të çdo anëtari të KUPV që dëmtojnë misionin dhe imazhin e institucionit apo autoriteteve drejtuese.

17.2. Sjellja e dhunshme ose kërcënimi, ushtrimi i dhunës fizike, sharjet, shpifjet, apo veprimet keqdashëse të çfarëdo lloji, ndaj çdo anëtari të KUPV, nga vetë anëtarët e këtij komuniteti, apo të personave të lidhur me ta në marrëdhënie martesore, lidhje gjaku e të tjera.

17.3. Studentët janë të ndaluar të flasin në emër të KUPV, me ndonjë organizatë të medias së folur apo të shkruar. Studentët janë të ndaluar të ftojnë në ambientet apo eventet e institucionit organizata të mediave, përjashtuar rastet kur merret leje me shkrim nga autoritetet drejtuese. Studentët si individë ose përfaqësues të organizatave studentore janë të ndaluar të hyjnë në marrëveshje verbale, me shkrim ose në kontrata që kanë për qëllim të lidhin, detyrojnë, ose krijojnë ndonjë lloj përgjegjësie për institucionin. KUPV do të njohë gjithë këta studentë individualisht përgjegjës për pasojat financiare, juridike ose dëmet që mund të rezultojnë nga veprime të tilla të paautorizuara.

17.4. Ofrimi ose dhënia e rryshfetit personelit të KUPV.

17.5. Përvetësimi i paautorizuar i aseteve ose shërbimeve brenda KUPV.

17.6. Plagjiatura e çdo forme.

17.7. Përdorimi i paautorizuar ose dhunimi i pajisjeve kompjuterike, pajisjeve të tjera dhe/ose mjediseve fizike të KUPV.

17.8. Përdorimi i alkoolit, duhanit, dhe/ose substancave të ndaluara brenda ambienteve të KUPV.

17.9. Çdo lloj veprimtarie apo sjellje që përbën vepër penale dhe/ose që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 18

Pasuria intelektuale

18.1. Personeli i KUPV duhet të jetë i përgjegjshëm për burimet e institucionit. E gjithë prona intelektuale e konceptuar, e prodhuar apo e shkruar nga fakultetet, personeli administrativ, studentët, duke përdorur fondet e institucionit, objektet apo burime të tjera të tij, duhet të jenë në pronësi dhe të kontrolluara nga KUPV.

18.2. Produktet tradicionale të veprimtarisë shkencore, të cilat konsiderohen si pronë epakufizuar e autorit të tyre, si psh. revista shkencore, tekste mësimore, monografi, të cilat janë të krijuara pa përfshirë përdorimin e burimeve të institucionit do të jenë pronë e pakufizuar e autorit. Ndalohet çdo formë riprodhimi e paautorizuar me shkrim nga autori.

Neni 19

Plagjiatura akademike

19.1. Plagjiatura është përdorimi i fjalëve, ideve, koncepteve ose të dhënave të një personi tjetër, pa e cituar atë. Plagjiatura përfshin përdorimin e drejtpërdrejtë dhe parafrazimin e fjalëve, mendimeve apo koncepteve të tjetrit pa cituar. Ajo përfshin, por nuk kufizohet në:

a. Kopjimin pa treguar, të paragrafëve apo pjesëve nga veprat elektronike dhe/ose kopje të punimeve të tjerëve, në detyra shtëpie ose kursi, ese, punime shkencore, apo teza;

b. Përdorimin pa treguar të pikëpamjeve, mendimeve, apo njohurive të një personi tjetër.

19.2. Shmangia e plagjiaturës akademike shërbën për të rritur cilësinë në kërkim e krijimtari shkencore. Kërkuesi është i detyruar të citojë në mënyrë të plotë e të saktë autorët dhe punimet e tyre, të cilat i ka konsultuar si burime të para apo burime dytësore dhe i ka përdorur për t'u informuar në lidhje me rezultatet e mëparshme, apo për të argumentuar dhe interpretuar rezultatet e veprimtarisë kërkimore.

Neni 20

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit të Etikës

20.1. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit të Etikës është Këshilli i Etikës, i cili krijohet dhe funksionon në përputhje me Nenin 44 të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe me Nenet 23 e në vijim të Statutit të KUPV.

20.2. Këshilli i Etikës analizon e diskuton probleme të etikës së jetës universitare.

Këshilli i Etikës shqyrton sjelle të ndryshme të personelit të KUPV dhe vlerëson nëse ato përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij kodi. Shqyrtimi i sjelljes së studentëve nëse ato përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij kodi do të bëhet në përputhje me Nenin 53, të Rregullores së Brendshme të KUPV.

20.3. Këshilli i Etikës ka për detyrë:

a. Të vëzhgojë zbatimin e dispozitave të këtij kodi dhe të propozojë ndryshime, përmirësime apo masa të tjera detyruese që kanë të bëjnë me etikën në KUPV.

b. T'i propozojë Rektorit masat disiplinore të parashikuara në këtë kod.

Neni 21

Procedura për trajtimin e shkeljeve

21.1. Në rast shkeljesh të dispozitave të këtij kodi, Këshilli i Etikës vë në dispozicion anëtarë për të analizuar, ndërmjetësuar dhe nëse është e domosdoshme, për të ngritur një Grup Dëgjimor.

21.2. Këshilli i Etikës mund të vihet në lëvizje kryesisht ose mbi bazën e një ankese me shkrim.

21.3. Mënyra e trajtimit të shkeljeve të raportuara është përgjithësisht progresive. Kjo do të thotë që procedura është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë opsione zgjedhjeje në faza të ndryshme, bazuar në seriozitetin e problemit apo fakteve që dalin gjatë shqyrtimit.

21.4. Cilido student apo anëtar i personelit që vë re, apo dyshon për një shkelje të dispozitave të këtij kodi, inkurajohet ta raportojë shkeljen tek cilido anëtar i Këshillit të Etikës, apo në zyrën e Rektorit, ose të Administratorit të Insitucionit, të cilët ia transmetojnë problemin Këshillit.

21.5. Kur Këshilli merr njoftim për një shkelje, Kryetari mund të caktojë një nga anëtarët të ndërmarrë rolin e ndërmjetësuesit dhe/apo të nxjerrë në dritë faktet.

21.6. Kur shqyrtimi është i plotë, personi i ngarkuar harton një përmbledhje me shkrim të çështjes dhe ia paraqet atë Këshillit të Etikës.

21.7. Pas shqyrtimit të rastit, Këshilli i Etikës merr vendim për masën disiplinore përkatëse, të cilën ia përcjell për miratim Rektorit.

21.8. Këshilli i Etikës i merr vendimet me shumicë të thjeshtë.

Neni 22 Masat disiplinore

22.1. Përveç shkeljeve që ndëshkohen nga dispozitat e Statutit dhe të Rregulloreve të KUPV, si dhe të atyre që përbëjnë figurë veprash penale që trajtohen nga dispozitat e Kodit Penal, shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë kod nga ana e personelit të KUPV, përbën shkelje disiplinore për të cilën parashikohet: Masë disiplinore "Vërejtje me shkrim" dhe "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna". Në rast se këto shkelje bëhen të përsëritura, si dhe në rastin e shkeljeve të rënda, Këshilli i Etikës i propozon Rektorit masën disiplinore "Largim nga puna".

22.2. Caktimi i masave ndëshkuese në parim do të ketë karakter progresiv përveç rasteve kur shkeljet janë të rënda. Caktimi i llojit të masës ndëshkuese do të bëhet në bazë të llojit të shkeljes, intensitetit, përsëritshmërisë dhe pasojave të ardhura.

22.3. Në rast të shkeljes së dispozitave të këtij kodi nga ana e studentëve, ata do të ndiqen disiplinarisht në përputhje me Nenin 53, të Rregullores së Brendshme të KUPV.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23 Dispozita të fundit

23.1. Në momentin e përfshirjes si anëtar i KUPV, në cilësinë e studentit, personelit akademik, administrativ, anëtar të oraganeve të ndryshme, të ftuar nderi etj. lidhjes së marrëdhënies së punës, Sektori i Burimeve Njerëzore ose Sektori Përgjegjës sipas rastit, ka detyrimin të njohë anëtarët me këtë dokument, përmbajtjen, detyrimet që rrjedhin prej tij dhe që duhet të respektohen nga ana e punonjësit.

23.2. Duke pranuar statusin e anëtarit në KUPV, secili punonjës bëhet i përgjegjshëm për pajtueshmërinë me këto standarde sjellje.

23.3. Çdo person, anëtar i KUPV, i cili vihet në dijeni për një shkelje të rregullave dhe normave të Kodit të Sjelljes në KUPV, ose udhëzimeve të tjera nga një anëtar tjetër, duhet të raportojë menjëherë eprorin përkatës.

23.4. KUPV do të marrë të gjitha masat e nevojshme për ta mbajtur të fshehtë identitetin e personave raportues, sipas përcaktimeve të nenit 23.3.

23.5. Shkelja e dispozitave të këtij neni përbën shkak për fillimin e procedimeve disiplinore.

23.6. Përgjegjësinë për të kontrolluar zbatimin e këtyre rregullave e ka eprori i çdo njësie.

23.7. Këshilli i Etikës është përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e këtyre rregullave.

23.8. Personat që shkelin parimet e sjelljes dhe etikës në punë të përcaktuara në këtë kod, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masa disiplinore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të KUPV.

Neni 24 **Hyrja në fuqi**

24.1 Ky Kod hyn në fuqi me miratimin nga Senati Akademik.